



## MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

në mes të

**Shkollës së Lartë Profesionale për Programim PROED**

dhe

**Sindikatës së Policisë së Kosovës**

Ky Memorandum Mirëkuptimi (në tekstin e më poshtëm "Memorandumi i Mirëkuptimit") është bërë dhe është nënshkruar në mes të **Shkollës së Lartë Profesionale "PROED"** me numër fiskal NUI 810866254, Rruga "Dervish Hima" p.n. Lagja Kalabria e Re, përfaqësuar nga Drejtori z.Ali Lushi, nr. kontaktues 049-389-992 dhe **Sindikatës së Policisë së Kosovës** me numër fiskal 600595899, Rruga "Luan Haradinaj" p.n. Prishtinë e përfaqësuar nga z.Imer Zeqiri-Kryetar, me nr. kontaktues 048-714-222, në vijim si "**palë**".

Duke pasur parasysh: rritjen e kërkesave të tregut për ekspertët e TIK-ut në Kosovë dhe në tregun ndërkombëtar kryesisht në vendet e BE-së;

Duke synuar këtë bashkëpunim do të rezultojë në një kontribut efektiv të përbashkët, i cili në perspektivë do të ketë bashkëpunim në mes të dy institucioneve në arsim, trajnim, intership si dhe në krijimin e vendeve të reja të punës;

Palët kanë rënë dakord për Memorandumin e Mirëkuptimit si më poshtë:

### Neni 1

#### Qëllimi memorandumi

Përmes këtij Memorandumi të Mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellë, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

## Neni 2 Fushëveprimi

Ky memorandum rregullon formën e bashkëpunimit të **Sindikatës së Policisë të Kosovës**, në njëerën anë dhe Shkollës për Programim PROED-it, në anën tjetër, lidhur me angazhimin e punëtorëve, studentëve në studime profesionale, trajnimet e ndryshme profesionale dhe punë praktike nga fusha e TIK-ut

## Neni 3 Lënda e Memorandumit

Me anë të këtij Memorandumi, shkolla profesionale e programimit PROED merr përsipër ofrimin kushteve të veçanta zbritje, për shkollim dhe trajnime për punonjësit e organizatës së lartpërmendur dhe familjarët e tyre.

Zbritjet ofrohen për nivelin e shkollimit profesional për dy vite studimi. Pagesa mund të bëhet deri me 12 këste dhe forma tjera të pagesës sipas mundësive të palëve.

Skema e çmimeve zyrtare dhe zbritjet e lejuara për anëtarët e **Sindikatës së Policisë të Kosovës**, për regjistrim në vitin akademik 2022/23 si dhe zbritjet për trajnimet profesionale aktuale të ofruara nga PROED:

<b>Çmimi për studimet 2 vjeçare është 2,000€ / një vite dhe Skema e zbritjeve të ofruara</b>				
Nr	Përshkrimi	Çmimi Zyrtar (€)	Përqindja e zbritjes (€)	Çmimi /një vite studime (€)
1	Zyrtarë aktiv në Policinë e Kosovës	1,250	20 %	1,000
2	Familjarët e zyrtarëve të Policisë së Kosovës	1,250	20%	1,000
3.	Fëmijëve e të rënëve në detyrë, veteranëve të luftës dhe femrat	1,250	25%	940

<b>Skema të shërbimeve tjera: Trajnime dhe Shërbime</b>				
Nr	Përshkrimi	Çmimi zyrtar (€)	Përqindja e zbritjes (€)	Çmimi pas zbritjes (€)
1	Trajnimet individuale, / 2 – 4 muaj / modulet e TIK-ut	250 - 500	20%	200 - 400
2	Trajnime grupore / 2- 4 muaj	225 - 470	25 %	170 - 350

Përmes këtij Memorandumit të Mirëkuptimit **Sindikata e Policisë së Kosovës** do t'i mundësojë studentëve të PROED-it përfundimin e punës praktike me kohëzgjatje të akorduar në mes të PROED-it, dhe sipas mundësive dhe kërkesave të Policisë së Kosovës.

Me anë të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, palët dakordohen që të bëjnë shkëmbimin e stafit (në raste të caktuara) për pjesëmarrje në ligjërata publike apo ngjarje të organizuara në frymën profesionale.

Për aktivitete të planifikuara PROED do të ofrojë staf kompetent dhe hapësirë me kushtet të nevojshme.

Palët do të bashkëpunojnë në ngritjen e renomesë dhe namit të ndërsjellët të institucioneve të tyre, si dhe të iniciojnë forma inovative të bashkëpunimit;

Palët do të hulumtojnë mundësitë e participimit në projektet kërkimore vendore dhe ndërkombëtare;

### **Neni 3**

#### **Kandidatët**

Kandidatët për shkollim dhe trajnime në PROED duhet të jenë anëtarë të Sindikatës së Policisë të Kosovës ose në rast se është familjar duhet ta dëshmoj me anë të certifikatës së lindjes, martesës, të bashkësisë familjare, ose dëshmime tjera ligjore për të përfituar nga zbritjet e ofruara sipas marrëveshjes.

### **Neni 4.**

#### **Përzgjedhja e Kandidatëve për Internship / Punë Praktike**

Përzgjedhja e kandidatëve për internship / punë praktike do të bëhet nga PROED duke marrë parasysh nevojat dhe mundësitë e Policisë së Kosovës.

PROED do të sigurojë që kandidatët e përzgjedhur të jenë të nivelit të përshtatshëm dhe të kenë potencial për avancim në karrierën e tyre profesionale.

Gjithashtu përfituesit e zbritjes nga kjo marrëveshje në mes palëve mund të bëjnë edhe puna praktike nga semestri i katërt në ndonjërin nga kompanitë e industrisë së TI-së në Kosovës dhe kompanitë jashtë vendi me të cilat PROED ka marrëveshje aktive të bashkëpunimit.

### **Neni 5.**

#### **Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni**

Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuar sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuara me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjërisë palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër.

Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë.

## Neni 6 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit etik dhe moral.

## Neni 7 Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi

Ky memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët;

Ky memorandum mund të ndryshohet për qëllime të zgjerimit apo avancimit të bashkëpunimit edhe në fusha tjera me interes reciprok me miratimin e të dy palëve,

Secila palë mundet kurdoherë të përfundojë këtë marrëveshje, me kusht që të njoftoj me shkrim palën tjetër së paku një muaj më herët.

*E lidhur në Prishtinë, më 21.10.2022*

Sindikates Policisë së Kosovës

Imer Zeqiri



PROED

Ali Lushi

